

YRJET BERISHA

SHNDËRRIMET IDEORE - LETRARE NË PROZËN E CAMAJT

Në interpretimin e veprës letrare, ideja është nocion që përdoret, zbatohet në disa kuptime dhe mënyra gjatë analizës së tekstit artistik. Andaj si i tillë ky nocion është i rëndësishëm, i ndijshëm, problemor, ndonjëherë i mjegullt, i paqartë, i padallueshëm, i papërcaktuar, i rrëshqitshëm etj. Meqenëse ky koncept teorik (nocioni i idesë) ka kaq kuptime e mënyra interpretimi si dhe mënyra zbatuese në ngrehinën e një veprë letrare, si e tillë ai mund të krijojë njëfarë hutie, jo vetëm te lexuesit, por edhe te kritikët, estetët dhe studiuesit e letërsisë. Për të pasur më të qartë çështjen e nocionit të idesë, në rreshtat vazhdues do të citojmë dy-tri shkrime të shkurtra marrë nga disa autorë tekstesh teorikë shkencorë: “Fjala “ide”, në të folurit e përditshëm do të thotë kryesisht “mendim”, “të menduarit”, “mendimi kryesor”; gjithashtu do të thotë dhe qëndrim i përgjithshëm për ndonjë problem, mendim apo projekt.”¹ Së dyti, lidhur me idenë si nocion në “Fjalorin e termave letrare” citojmë edhe këtë tekst: “Ideja e veprës letrare është e njëjtë me motivin operues, por jo edhe krijuese e veprës së konstruktuar, ajo pasqyron probleme artistike, zgjidhja e të cilave është veç në vepër. (...) Ideja e veprës letrare artistike nuk mund të formulohet jashtë ose para veprës, ashtu siç ndodh në veprat erudite letrare, por edhe në veprat shkencore.”² Së treti teoriku dhe esteti bashkëkohor i letërsisë, akademik Milivoj Solar, në veprën e tij: “Teoria e prozës”, për nocionin e idesë në letërsi shkruan kështu: “Meqë nocioni i idesë merr kuptime themelore në shumë metoda interpretuese të veprave letrare, me të drejtë mund të supozojmë se ideja qysh në kuptimin e parë “shkatërron” autonominë e letërsisë, sepse veprat letrare në esencë janë të ngjashme me traktet e filozofisë. Në kuptimin e dytë ideja shfaqet si një term teknik i analizës dhe si një nocion ku nuk mëton të përfshijë në mënyrë sintetike të ashtuquajturin vlerësim letrar që në këtë kontekst nënkuptohet se prania e mendimeve dhe e gjykimeve në vepra letrare,

¹ Milivoj Solar: “Hyrje në shkencën e letërsisë”, botim i përkthyeses Prof. Dr. F. Dado, Tiranë, 2004, f. 45.

² “Fjalori i termave letrare”, botuan: “IKUB” (Instituti i Letërsisë dhe i Arteve në Beograd) dhe “Nolit”, Beograd, 1986, faqe 256.

*merren si elemente të veçanta të strukturës së letërsisë, pa pasur frikë se letërsinë do të barazojë me filozofinë*³.

Ashtu si në shumë vepra letrare të shkrimtarëve të tjerë edhe në prozën e Martin Camajt, (siç janë: “*Djella*”, “*Rrathë*”, “*Karpa*”, “*Pishtarët e natës*”, “*Shkundullima*”, “*Katundi me gjuhë të fshehtë*”, “*Rrungaja në mars*”, dhe “*Dranja*”) nocioni i idesë pasqyrohet në disa *kuptime ose mënyra*⁴ të cilat gërshetohen me *motive*⁵, *personazhe*⁶ në një vepër letrare që në makrostukturën narrative kur lexohen, analizohen këto koncepte artistike, në shkencën e letërsisë, shndërrohen: nocion i idesë i cili bashkëjeton harmonishëm me shtresa strukturore të veprës letrare; *bart*⁷ rrëfimin bazë dhe anësor. Këto tekste letrare kanë nocione të ideve etike, antropologjike, mitike, mistike, kanunore, etnike, historike, politike, religjioze, folklorike, filozofike, psikologjike, metafizike, arketipike, morale, imorale, logjike, sociologjike, kozmopolitike, patriarkale, matriarkale, makiaveliste, futuriste, luftëra qytetare, diktaturë, jetë private e intime etj. Veç këtyre çështjeve artistike, prozat e Martin Camajt, metamorfozohen si tekste letrare, estetike që fisnikërohen edhe me mjete artistike si: alegoria, ironia, metonimia, portresta, sarkazmi, surrealizmi, tekste me rrotlla etj.

Veprat letrare në prozë të Martin Camajt janë tekste fiktive që anojnë nga arti me përmasa nacionale, me peshën e etnosit, të filozofisë, të ligjësisë, të dokeve tona, të mentalitetit malësor. Në mënyrë të veçantë shkrimtari njeh mitet, legjendat, këngët kreshnike, historinë, gjeografinë, psikologjinë, filozofinë etj. Ka një barometër të saktë e origjinal për dilemat e mëdha që e munduan njeriun tonë ku problemet bëhen shkaktarë të ngritjes së spirales së të papriturave e fatkeqësive reale, që në art thjesht ndërrojnë origjinën, shndërrohen në ide e fiksjon që transplatohen në veprën letrare, natyra e së cilës merr ngjyrën e veçantitë që shfaqen si

³ Millivoj Sollari: “*Teoria e prozës*”, botoi “SNL” (Botime Universitare “Liber”), Zagreb, 1989, faqe 104,

⁴ M. Solar: “*Hyrje...*”, Tiranë, 2004, faqe 45, shkruan se: ideja ka *disa kuptime ose mënyra*.

⁵ “*Fjalori i termave letrare*”, burim i cit. F. 256. Prof. Dr. Millan Damjanović, nocionit të idesë i jep si cilësi atë të “*të motivit operues*.”

⁶ Ollga M. Frejdenberg: “*Figura dhe nocioni*”, botoi “NZMH”, Zagreb, 1986, fq. 139,

⁷ Ollga M. Frejdenberg: “*Figura dhe nocioni*”, botoi “NZMH”, Zagreb, 1986, fq. 139, shkruan se: “...personazhi është bartës i ideve bazë, thjesht, instrument për zhvillimin e këtyre ideve.”

produkt i ideve dhe i fiksionit të logjikshëm, modeluar me art të mirëfilltë letrar. Ndërkaq, esenca e këtij shndërrimi artistik mbështetet në poetikën që buron nga ligjësitë e natyrshme të zhvillimit të qenieve njerëzore, që reflektohen artistikisht në shtresat e thurjes së tekstit artistik.

Meqë autori jetoj jashtë atdheut, kundrimi dhe pasqyrimi i problemeve e motiveve aktuale në shoqërinë shqiptare s'ishte gjithaq i lehtë, ngaqë Camaj i rikonstrukttoi problemet, intrigat komplekse të diktaturës. "Karpa", ku ndriçohet motivi i lashtë i fejesës, i cili të kujton mitin e Halilit që s'deshi të martohej me një vashë të atij visi ku jetonte.

Parë nga shndërrimet ideore, teksti i romanit mëton të trajtojë motive të ndryshme nga shtresat e asaj hapësire me një statistikë me shumë ekzemplarë, që gjallojnë në rrethana të veçanta të cilat s'duken të mbijetojnë. Karpa i ngjet një qendre laboratorike, eksperimentuese ku zhvillohen veprimtari të shpifura nga një sistem totalitar. Pikërisht aty zë fill e shtjellohen shumë probleme absurde që kalojnë nëpër shpatullat e brishta të njerëzve. Vështruar përmes thjerrëzës interpretuese, shkrimtari Martin Camaj, shtresat strukturore të këtij romani i mbarështron sipas poetikës së romanit postmodern, por pa iu larguar poetikës së artit magjik etj. Zbatimi e artikullimi i tillë romanësor, në të njëjtën kohë ka si qëllim parësor që teksti letrar të përfshijë tërë hapësirën e idesë së romanit të ngjeshur me komponente të shumta artistike. Kështu, parë në këtë frymë, autori zbulon dobësitë e barinjve, të cilët duken se krekosen kot, por e vërteta del ndryshe. Ata kanë një të metë që s'arrijnë të kuptojnë se janë të instrumentalizuar, dorë e zgjatur e kryetarit të Katundit (a të Ajkës) që di t'i shfrytëzojë dhe kështu me këto veprime ata marrin epitelin e renegatëve e të veglave parazite që shërbejnë për ndezjen e luftës qytetare në Karpë. Brenda faqeve të këtij romani, motiv pas motivi ngjizet retrospektiva narrative me artin absurd me përmasa psikologjike. Ngjarjet e romanit "Karpa" zhvillohen në vitin 2338 (ose edhe treqind vite më pas). Fabula shpesh i kthehet së kaluarës në Iliri, ngjarjeve e heronjve të trilluar, shqiptuar me alegori për gjendjen kaotike, të krijuar nga dora e fortë e diktaturës së padukshme, por të rrezikshme për cilindo në Karpë. Romani ka një varg idesh e motivesh që janë modeluar bukur. Lufta në faqet e këtij romani nuk ka hapësirë të shtrirë. Rrëfimi bëhet në formë fantastike meqë paraqet vuajtjet e heroit që bashkëjeton në një shpellë i mbyllur me insekte dhe shpezë. Problem ka mbijetimin a luftën e Vonit për ekzistencë. Dhe këtu romani ka shtresa të filozofisë ekzistencialiste, trasuar nga dramat e Zh. P. Sartrit, që përmes këtij arti dramatik bëri emër si filozof bashkëkohor evropian. Historia në këtë roman pushon së qeni e tillë. Bëmat e tilla shndërrohen në tekste letrare me ide, motive, kompozicion

thurur me fije të tjerrura fiktive. Brenda këtij materiali trillues ngrihet vetëdija për të qenë i lirë. Lufta mbështetet në motive karrieriste. Ajo është tragjedi për të dyja palët.

Arti i romanit “Karpa” hap shtresa të reja filozofike përmes metonimisë dhe alegorisë therëse, ndriçon babëzitë e padëgjua e të papara të një mjedisi të ndërlikuar, me jetën krejt të veçantë të një fisi me halle shumë, të vendosur në një shekull virtual (të së ardhmes) mbështjellë me pikëpyetje të karakterit filozofik. Herë-herë heronjtë u ngjajnë somnambulëve, herë pas here dragonjve a argonautëve, imoralëve, ndonjëherë edhe sançopanceve. Kështu, brenda këtyre kundrimeve vështrohet bota e ardhme, që në fakt paraqet përditshmërinë monotone të Shqipërisë së izoluar. Tërë horizonti i simbolikës së kësaj poetike sillet rreth orbitës së ligjësive kanunore të maleve.

Vepra “Karpa” ka disa motive kryesore: izolimin, plogështinë, kryengritjen, ligjet specifike, sundimin e amazonave përmes një njeriu senil, ambiciet e sëmura për pushtet, dashurinë tabu, doket e trashëguara, etj. Pikërisht këto motive autori ia ka arritur t’i ngrejë mbi sferën e kujtimit të parë, që duke i gërshetuar, këto çështje marrin kuptim tjetër: heronjtë e tij janë gjysmëzotër, magjistarë, dragonj, orë, kreshnikë, argonautë, zana, sirena, nimfa, zejtarë, rojtarë etj., të çmitizuar nga sistemi i pushtetit në fuqi. Kështu, ata janë “tokësorë”, njerëz të thjeshtë, të përbuzur, jetojnë një jetë të vështirë, në shpirtin e tyre sundonte dora e klikës së Qytezës, në krye me plakat e mjera që i manipulon Ajka, përmes Katallanit kokëzbrazët. Protagonistët e këtij romani jetojnë në gjendje të shtetrrëthimit klasik. Ata kanë shtëpi, por nuk e gëzojnë jetën në të. Gratë e burrat (barinjtë) bëjnë jetë të ndarë. Pleqtë për shkak të “herezive” të dikurshme qenë zhburrënue e vendosur në Kopshtin Zoologjik a në një shtëpi azili që i ngjan burgut. Forma e banimit përcaktohet nga shtresat shoqërore që duket se s’kishin emocione njerëzore, por sillen sikur të ishin jashtëtokësorë. Jo pse ata donin të ishin ashtu, por kështu iu imponohej të jetonin në këto rrethana, meqë sistemi i korruptuar ua kishte humbur toruan për jetë normale e të rëndomtë si ishte: dashuria, liria, liria e të menduarit, edukimi, qe ndaluar arti, etj., të gjitha këto haseshin në kronika, filma, libra që për fat të keq ishin të ndaluar për banorët e thjeshtë të Karpës.

Heronjtë e getoizuar e të sflitur nga puna e kotë ballafaqohen me mungesën e ushqimit. Edhe ato pak ushqime që kishin, ishin të pakta e s’guxonte askush t’i prekte. Banorët jetojnë e punojnë brenda një hapësire të kufizuar, kurse pleqtë jetojnë të izoluar në Kopësht Zoologjik, në shoqëri me shtazët e egra. Kur shikohet statistika e banorëve, kuptohet

menjëherë se në atë mjedis shtresat e ndryshme shoqërore janë të ndara, pleqtë janë të harruar, të urrejtur etj., meqenëse ishin shpallur gjysmëzotër, donin t'i varrosnin për së gjalli në Kopësht. Strukturat e tilla shoqërore i tërheq zvarrë segmenti i inercisë kundërshtuese që ishte pjellë e pakënaqësive dhe që shtynte kah grindjet, kryengritjet, krimet e një lufte qytetare që diskursi e quan: zezonë.

Parë në kuptimin e nocionit të idesë psikosociologjike, Malësia e Camajt është e njohur për më shumë legjenda e burra bujarë e fisnikë, punëtorë, zejtarë, që edhe pse janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe jetojnë në varfëri, janë të matur në fjalë, s'dinë se ç'është urrejtja, zemërimi, inati, janë mikpritës, zemërgjerë, të zgjuar, të gjindshëm në çdo situatë etj. Autori në mënyrë origjinale pasqyron rregullat e jetës patriarkale në katunde, shtëpi, qendra blegtorale, ku burrat janë të zotët e shtëpisë, kryetarë, përgjegjës, drejtorë, etj., por ka raste kur edhe pse nuk kishin përgjegjësi të mjaftueshme në mjedisin e vet, jetojnë si parazitë; urdhërojnë e s'punojnë asgjë, punët e ndryshme kalonin në kurrizin e grave të tyre që punonin ditë-natë. Ato janë nëna të devotshme, por trajtohen si vejusha, robërësja. Kishte edhe të atilla që iu ngjanin zanave e perrive. Ato me shpesh urrehen, rrihen, dhunohen, sesa dashurohen.

Ç'është e vërteta, luftën e pasojat e saj autori i pasqyron në mënyrë të përciptë. Lufta më tepër jeton në mbamendjen e brezit të vjetër, që ua kishte ritreguar pasardhësve të fisit që paraqiten herë pas here edhe në romanin e shkurtër "Pishtarët e natës". Fjalën e kemi për të atin e Nikës që vdes në Jemen, duke shërbyer si ushtar i paguar (mercenar) i ushtrisë turke. Bijtë e tij, për këtë rast, qenë traumatizuar, sa t'atin s'e përmendnin me ëndje. Ndryshe nga vëllezërit, Nika mendon dhe e arsyeton veprimin e tij, se ai kishte shkuar për të siguruar tokën e bukës për vete e të bijtë; atëbotë toka ishte shumë e çmueshme për të dalë nga mjerimi. Një motiv të ngjashëm me këtë e trajtoi në veprën e tij edhe Gj. Fishta, kur Marash Uci, kreshnik, në rini kishte qenë luftëtar turk.

Krejt ndryshe janë raportet në romanin "Rrathë", aty banorët e Tri Ripave, kanë alergji ndaj njerëzve të pushtetit të ardhur nga fusha. Ata kanë fuqi të jashtëzakonshme dhe organizim befasues për të mbrojtur Cubin. Pastaj janë aq të shkathët sa pushtetin e fushës e ironizojnë se ishin të verbër, meqë u shërbejnë personave të prirur të bëjnë çdo gjë për të nënshtruar malësorët dhe në këtë rast edhe donin t'ua humbnin të drejtat. Shkrimtari është mjeshtër i fjalës artistike, ai shkruan për çështje të ndryshme dhe shumë të ndjeshme, tekstet në roman kanë shumë figura artistike si: metonimi, ironi, alegori, simbol, etj. dhe një arti të gërshetuar,

që qëndron mes linjës së artit klasik e atij modern, pa rënë në kthetrat banale të metodës realsocialiste.

Duke kundruar fabulën e këtij romani e të prozave të tjera, autori nuk zhytet në historicizëm, por i rri besnik poetikës, duke hulumtuar psikologjinë e shpirtin intim të personazheve; në këtë mënyrë edhe veprat marrin pamjen dhe konturat e qëndrueshme të artit të mirëfilltë. Thjesht hyjnë në mesin e prozave serioze të letërsisë sonë. Pjesa dërrmuese e artit të tyre mban vulën e epit kreshnik, verior, që është krenaria e popullit, ajo ruan tonin origjinal të malësorëve që janë arketip i kreshnikëve. Personazhet s'janë të pa probleme. Arti i ligjërimit buron nga shpirti i tyre, që rrjedh në mënyrë të heshtur, ku edhe spikat bota e brendshme që ka nivel të ngritur në suaza të artit të sprovuar nga një vokabular i vëmendshëm e tolerues që gjithmonë fjalët i qëmton dhe i shqipton me logjikë, duke u mbështetur në urtësinë e lashtë të popullit.

Banorët, që jetojnë në qytete, u përkisnin shtresave të ndryshme, ata ishin zejtarë të zejeve të ndryshme, kryetarë visi a qyteti, shmirjakë, ushtarë ose argonautë, nëpunës të ndryshëm, mësues të harruar, por të nderuar, gazetarë kryengritës, policë të detyruar të kryejnë punë kriminale, shkrimtarë të izoluar, shkencëtarë të harruar e të varrosur për së gjalli, artistë të injoruar, politikanë të instrumentalizuar, diktatorë senilë, amazona të pashpirt, nimfomane të rrezikshme, sirena provokuese, kodoshë të mërzitshëm etj.

Sistemi totalitar (në romanin “Rrathë”) është “vigjilent” dhe ka në shënjestër çdo njeri që punon e jeton në mënyrën e vet. Edhe zhurmën e fjalët më të fshehta një sistem i tillë “i dëgjon”, për këto arsye ata angazhojnë “specialistë” të eliminojnë çdo zë kundërshtues, pa i dhënë llogari askujt, duke u mbështetur në disa parime absurde të luftës së klasave, që sipas filozofisë së tyre çnjerëzore “armiqte” duhet të hanë dhe. Masat represive duken se kanë sukses në ambientin urban, por jo edhe në atë rural. Përkundrazi, ata solidarizohen me Cubin që himnizohet si hero dhe merr dimensionin e famën e arketipit kreshnik.

Mrekullia e këtyre prozave qëndron në faktin se idetë e tyre arti i ligjërimit nuk i merr nga faqet e historiografisë, por thjesht nga imagjinata krijuese si edhe nga letërsia popullore dhe kështu shndërrohet ideja dhe ndërtimi i këtyre teksteve letrare, që janë prodhim i hapësirës etnike, kreshnike.

Duhet përjashtuar në këtë rast novela “Gjon Gazulli”, ku autori mëton ta shkruajë tekstin letrar mbi biografinë e një shkencëtari (të mesjetës sonë) diplomati, vëllai, filozofi, dashnori, humanisti të vetmuar, që në kohë të pleqërisë kujton dhe e çmon origjinën e gjuhën e të parëve, të cilës nuk i

që kushtuar sa duhet dhe nuk i ndihmoi të zbardhë diç nga ajo periudhë e lavdishme. Etnosi, etosit, doknorët, kanunorët (si kategori antropologjike, por edhe dragonjtë, zanat, orët, shtrigat, perritë, rapsodët, artistët, hijet, shpirtërat, djajtë, hamshorët, sirenat, kodoshët, nimfat etj.) janë disa nga arketipët e diskutueshëm të korpusit e të strukturës ideore që provokojnë tek lexuesi këto nëntekste të bazuara në arketipat e sipërshënuara.

Me një mjeshtëri të rrallë, autori pasqyron atmosferën e riteve, të të kremteve, festave të ndryshme të malësorëve, si në romanin “Rrathë”, kur festojnë dyndjen e barinjve me bagëtitë nga bjeshka. Një ceremoni e tillë ka pamjen e një festivali mbretëror, një herë ose dy herë në vit këndohen këngë kreshnike, vallëzojnë, ushqehen në mënyrë princore një herë ose dy herë në vit, andaj edhe banorët e asaj krahine gëzohen, por edhe kujdesen të mos bëjnë gabime e të mos i zërë sherri me sistemin. Veç këtyre çështjeve, autori paraqet edhe rite të tjera që mbështeten në etikën, filozofinë popullore, doket e traditën e rrallë të viseve malore. Këtu hyjnë edhe ritet e të kremteve familjare ose kolektive, siç është organizimi i detyruar i pritjes së traktorëve në Ripë. Ka qëllime të paqarta, me prapavijë provokuese dhe në një farë mënyre matet pulsi i opinionit, por edhe futen në ledhe për të zbuluar a ndriçuar çështje enigmatike, bazuar në psikën e ndjeshme të malësorëve që nuk flasin shumë. Në këto rrethana vërshojnë paragjykimet, fjalët shpifëse, të cilat i kurdis sistemi.

Ideja në romanin “Djella”, si element i strukturës letrare, ka rëndësi të dukshme, shfaqet në rrafsh të ndryshme motivore. Në mënyrë të veçantë poetika e veprës realizohet nëpërmjet arkitekturës së lirikës, me një rrëfim meditues, dialog të logjikshëm dhe një monolog të kondensuar. Rrafshi i parë shfaqet në përdorimin e një narracioni të kursyer, që duket se evoluon në raport me evoluimin e marrëdhënieve të acaruar njerëzore dhe kështu vërtitet nëpër horizonte e segmente të natyrshme të shpirtit të ndjeshëm e të thjeshtë, që ndjehet i nëpërkëmbur nga ingranazhet e pushtetit represiv. Në këtë vepër letrare nocioni i idesë shfaqet me shtresa filozofike, bazuar në jetën e banorëve të zakonshëm, që varet nga qeveritarët, parimi i të cilëve është t’ia zënë gojën çdo kundërshtari dhe t’i eliminojnë eksponentët e rrezikshëm, të cilët çmoheshin e nderoheshin si intelektualë, nxënës, mësues, poetë.

Në një fazë tjetër shfaqet ideja e personazheve (në romanin “Djella”) që janë në konflikt, (si Bardhi e ndonjë tjetër) që vërejnë se sulmet fyese, persekutuese përplaseshin mbi ta. Aty ka pezëm e urrejtje, për shkak të dhunës së aparatit të egër shtetëror që me banorët e asaj ane ushtron terror, vetëm pse s’binden me zgjedhën e imponuar, edhe pse nga varfëria mezi mbaheshin dhe shpirti u kishte ardhur në majë të hundës. Andaj, mu për

këto arsye ata s'përfillin atë sistem që bie ndesh me mënyrën e jetesës dhe mendësinë e tyre. Një gjendje e tillë hap hulli ndasie mes njerëzve, por edhe në fushën filozofike, psikologjike, shoqërore etj. Qëllimi i tyre ishte t'i nënshtrojnë, për të zgjatur më shumë jetën e diktaturës.

Gjatë leximit të romanit "Djella" shfaqet imazhi i veçantë i një province të harruar mes një moçalishteje që nuk jemi mësuar ta hasim në faqet e teksteve të artit të këtij autori. Ndërsana ka tipare të ndryshme nga hapësirat e tjera të gjeografisë së opusit të tij letrar, këtu ajo është e vendosur në një fushë, mes malësisë e qytetit. Në këtë hapësirë, krahas klimës e ambientit jo të përshtatshëm e të mërzitshëm, jetojnë banorët, që i nëpërkëmb, i injoron qeveria. Mes kësaj dileme ngrihet fuqishëm ideja polarizuese e atmosferës tendosëse që ekzistonte mes banorëve me origjinë vendase dhe ardhacakëve që dalin me ngjyra banale.

Parë nga konteksti ideor filozofik, shkrimtari i kushton rëndësi ngritjes së problemeve njerëzore, etike, praktike, katarsisit etj., ndërtuar nëpërmjet një nënteksti të ngritur në një sipërfaqe të diskursit të ngjeshur. Në këtë fushë dominante, arti i ligjërimit mëton të trajtojë një aliteracion të ngritur me një semiotikë kohezive, ngase receptimi kërkon një dekor të gërshetuar me artin modern. Kompozicioni i veprës parodizon gjërat banale: jetën gjasme të re (sic), por kunjat e pengesat patriarkale zvetënojnë imazhin e ëndrrave të të rinjve. Shtresat artistike me teksturë magjike e fantastike në romanin e parë autori i paraqet edhe me këtë fragment: "*Tri vjet rresht mbas largimit të saj nga Ndërsana çdo mot të Ri, dikush anonim, mbas hamendjes së Bardhit Djella, i paska dërgu dhuratë një kulaç, lloj ambëlsine që e gatojnë në Ndërsanë me miell gruni të fortë. Në tulin e çdo kulaçi ai kishte gjetë një monedhë argjendi...Derisa të tjerët veprimin e saj e interpretonin magji, vetë Bardhi pohon se ajo donte me jetue në kujtesën time për disa stinë...*"⁸

Arti i ligjërimit në roman nis nga një sprovë e dobësive njerëzore a luhatje ndjenjash, ku në fund rrënohet koncepti e morali i rrejshëm tek ato qenie njerëzore që nuk i përballonin kthetrat lajkatare e agresive që shfaqen me tërë kompleksin e tyre, ashtu sikundër i gjejmë të bollshme në letërsinë disidente të Evropës Lindore (pikërisht në romanin "Shakaja" të M. Kunderës), ku shtresat e ngrehinës letrare dinë të ngjyejnë majën e mprehtë të shigjetës në lëngun e ironisë së helmatisur kundër diktaturës së tërbuar ultraortodokse.

Mbi të gjitha, kujdesi i autorit është i dukshëm; ai ka këndshikim origjinal për dukuri, probleme, çështje, etj. Të gjitha këto dilema i shikon

⁸ M. Camaj: "Djella", faqe 135.

pa ngarkesa emocionale. Përmes shtrirjes së hartës, rrënon moralin e rrejshëm, shkund intrigat e purpurta puritane të kohës, që mbretërojnë në ambientin rural. Mësuesi mbyllet në shpirt dhe vepron ashtu, sepse e sheh se diçka lëvrin në ndërgjegjen që kalon nëpër sprova amullie dhe jete të mërztishme e të kotë. Ç'është e vërteta ai e dinte se ç'po ndodhte me të, por ngurron të reagojë, për të mos pasur probleme edhe më të mëdha, rri i izoluar në mënyrë absurde, nuk e kundërshton atë gjendje që mëton t'ia ngulfatë jetën. Mbyllet i vetëm e i rrethuar në banesë e shkollë dhe ka frikë se mos e lëndon shpirtin e kolegut të ri kur merr guximin t'i rrëfejë i drojtur në dhomën e tyre gjysmë të errët. Një rrëfim i tillë ka formën e metatekstit të hapur.

Këto ide e motive të ndjeshme i kultivon autori duke iu dhënë një formë origjinale. Dukuritë e ndryshme të shoqërisë shqiptare autori i qëmton dhe e gërsheton me kujdes me synimin për ta nxjerrë njeriun nga ankthi i rëndë e pa rrugëdalje.

Novela e gjatë "Pishtarët e natës" është një vepër që lidhet me jetën e banorëve të malësisë. Brusha e peneli i autorit paraqesin një periudhë të hershme të jetës së një malësoi të varfër. Në tekstin e kësaj novele autori trajtoi motivin kompleks të mercenarizmit, që të bijve u sillte si një vello në mendjen e tyre e nuk e kanë lehtë ta kuptojnë e pranojnë të vërtetën për të atin. Veprimi i tij është aventurë që dëmton fisin para të tjerëve dhe ai parodizohet e bëhet objekt talljeje. Fronti i luftës së tij s'është vetëm i tij, por edhe i popullit tonë që, fatkeqësisht, shpeshherë mori pushkën të luftojë për të huajt.

Mjediset feudale e malësore kanë vlime e huqe injorante, në disa raste duket se nëpërkëmbin dinjitetin e njeriut të pafuqishëm. Pikërisht këto përpjekje të vazhdueshme sillen brenda vorbullës së ideve të përgjithshme që nuk i lënë anash edhe shumë momente intime të nënkuptuara. Brenda faqeve të kësaj proze shfaqet shtresa e artit abstrakt. Ka dashuri të ndaluar e të pazbuluar. Shfaqet dukuria e urrejtjes, evoluimi i instikteve të mbijetesës; me qenë a mos me qenë!

Në këtë rast s'duhet lënë pa theksuar ngritja e një ideje të ndjeshme në prozën e tij, ku autori heronjtë, shpeshherë, i bën bashkëpunëtorë të sistemit në fuqi. Shfaqja e një arketipi të tillë në prozën e shkrimtarit duket e efektshme për lexuesin. Kjo ide e këto motive janë të njohura në letërsi (nga "Fausti" i J. V.Gëtes) si sindromi a kompleksi i shpirtit të shitur te dreqi. Kështu ndodh me të atin e Nikës, një malësor shqiptar i besimit katolik që bëhet aleat i armikut. Diç e ngjashme i ndodh edhe Vonit, që u shërben komplotistëve në Qytezë. Para një dileme të tillë vihet edhe Gjon Gazulli, venedikasi e padovasit shfrytëzojnë aftësitë e tij deri sa kanë

nevojë, por kur plaket e përgjojnë dhe e lënë në rrugë, ku edhe vdes në vetmi. Këta ishin heronj që kur i shikojmë në topos janë personazhe tragjikë, të rëndomtë, që nëpërkëmben nga sistemi e njerëzit e pandërgjegjshëm.

Motivi i sirenave e i hyjnive rrinë afër në këtë novelë. Ky subjekt sipas një studiuesi, zbulon idenë e personazheve “të ndarë në shkollën e njëjtë; si motivi, tema ose fabula që janë elemente strukturalë mes tyre.”⁹ Proza e këtij autori përmbush dilemën e një ngrehine letrare që s’është pa dekor, pa art modern, pa ngjarje kronologjike që bredhin nga njëri kapitull në tjetrin, nga një karakter në tjetrin, nga njëri metatekst në tjetrin, nga njëri paratekst i dimensionit nacional në tjetrin.

Kjo prozë me inde e rreze komplekse tejet platonike, ka ide fatale, disi e mbarështruar me sindrom paternalist dhe ka athtësi të pështirë bordeli. Por, ka edhe mrekulli hyjnore, ka pamje magjike, ka shkëlqim fantastik, ka përfundim parabolik. Kështu duke i trajtuar këto shtresa të tekstit artistik krijohet përshtypja se këto dukuri prekin dhe mbesin të pazbërthyer qëllimisht, për të provokuar lexuesin, për të nxitur debate rreth një arti të tillë. Arti i ligjërimit i njeh të gjitha këto shqetësime, por qëllimshëm hesht dromcat problemore që janë tharmi i frymëzimit të shkrimtarit.

Autori është i vëmendshëm në pasqyrimin e botës; s’është adhurues i forcës, i dhunës, i keqtrajttimeve, i keqbërësve, i injorantëve etj. Heronjtë e tij, qofshin edhe barinjtë më të humbur, në gjenet e tyre kanë të trashëguar ndjenjat fisnike e burrërore dhe mprehtësinë intelektuale. Kurse në të kundërtën, heronjtë e arsimuar çmitizohen: bëjnë gabime, janë idealistë të sëmurë, spiunojnë, dhunojnë etj. Në këto korpuse delikate autori nuk kursen askënd: qoftë kryetar, drejtor, poet, kryeplak, mësues etj., të cilët marrin dënimin e kodoshëve e të nimfomaneve psikopatë. Këto dukuri shfaqen në çastet e dobësive, çmohet ndjenja vetjake, instrumentalizohen, kërcënohen dhe rrezikohen, në mënyra të ndryshme etj.

Novelat “*Katundi me gjuhë të fshehtë*” dhe “*Shkundullima*”, kanë një temë të jetës arbëreshe, gati të harruar për lexuesit tonë. Novelat në këtë tekst, kanë botën e personazheve që shkelin në metodën e filozofisë transcendentale. Personazhet autori i vendos në një ambient sa të lashtë po aq edhe bashkëkohor, ku theks të posaçëm u kushton ndjenjave sublime të botës arbërore: diskursi në këto tekste letrare i qëmton këto ide me korrektësi, pedanteri, por edhe krenari, kur rikujtohen të parët tanë arbëreshë, këta burra të dheut të arbërit. Ata flasin gjuhën e lashtë

⁹ Millivoj Sollari: “Ideja dhe rrëfimet”, nënti. (Aspektet e teorisë së prozës), botoi “Liber”, Zagreb, 1977, faqe 138.

autoktone, ruajnë traditën e origjinën mes gërmadhve me plot ledhe e shkëmbinj, që janë një botë e pazbuluar. Pas një jete monotone Vitoi kthehet në vendlindjen arbërore, ku nuk e presin mirë. Zemra e tij i ngrohet e qetësohet kur takon vashën e quajtur Ntonie që do ta dashurojë marrëzisht. Dikur, kur rizbulon dashurinë, bëhet i vlefshëm për atë mjedis; vë në plan të parë ndërtimin e urës së katundit mbi përrua.

Në prozat e tjera të Martin Camajt shfaqet dashuria e flaktë që zhvillohet në rrethana të ndryshme, përfundimi i tyre është i beftë ose parabolik. Diskursi i tyre shtrohet në mënyrë të ndryshme, i jep ngjyrë mitike platonike, llahtari sirenash e nimfash, kurthe kodoshësh, etj. Të gjitha këto ide shtrohen brenda ngrehinës letrare, por që tek receptimi i lexuesit shfaqen herë dominante, herë polifonike, herë parodike, mbi të gjitha bëhen interesante shtresat që ndërtojnë nivelin e prozës së këtij autori. Të gjitha këto elemente artistike kanë strukturë që mëtojnë të mbesin gjatë në kujtesën e receptimit, pikërisht si proza të nivelit të lartë artistik.

Të gjitha këto motive i gjejmë në disa proza të Camajt, ku ka heronj fatprerë që janë mes dy zjarresh, ëndërrojnë të paarrtshmen e universit aksiologjik të personazheve të dikurshme, mallkojnë prishjen e lumturisë, s'përfillin doket dhe s'duan të bëhen viktimë e joshjeve të rastit. Komplekset e kësaj natyre janë të tejdukshme dhe janë thembër e Akilit për shumë heronj të Camajt, që lënë përshtypjen se janë të paformuar, euforikë, nuk e kontrollojnë veten, por në fakt ata janë arketipa të cubave e të kreshnikëve që dinë t'ua vjedhin zemrat vashave me tipare të zanave e të orëve. Pikërisht ky problem në letërsinë tonë interpretohet si motiv i dimensionit mitik, por edhe intim që shpeshherë bëhet objekt i fatkeqësive shoqërore, fisnore, individuale, por në planin estetik e artistik duken se marrin karakter katarsisi (kullimi) të një poetike të ngrehinës së lashtë.

Në romanin e shkurtër “Pishtarët e natës” autori paraqet fatin e një familjeje malësore, që nis me përfshirjen e një game të gjerë idesh, grindjet e vëllezërve përfundojnë me largimin e Nikës, që akuzohet si kryegrindavec dhe mohojnë deri në skajshmëri. Për këtë rast të afërmit e të njohurit thonë: “(...) e ka marrë e ama ndër ferra, (...) ashtë kopil!” Veç kësaj dileme mohuese në formë parodike, diskursi merr edhe një kahje tjetër dyshuese: “*Dikush i ka ba mëngji në djep, tue i fry në fytyrë dyshimin.*” Pos këtyre ideve e dilemave absurde të lloj-llojshme, shkon në Fundinë dhe ua kishte marrë dorën punëve bujqësore, zë mend, bëhet zemërgjerë, vdes i kënaqur mbi tokën e vet ashtu si vdesin dragonjtë. Këto dhe shumë fjalë miradie kishin pohuar vëllezërit e tij vetëm pas vdekjes.

Nika është arketip i njeriut të mirë e punëtor. Ai është viktimë e shpifjeve të shumta, zanafilla e të cilave fillon nga vëllezërit, djemtë, fisi dhe barinj të trillues që nuk e duronin Nikën “bandill”, i cili qe bërë gaz i botës, sipas tyre. E vërteta ishte krejt ndryshe dhe këtë “fshehtësi” e kupton së pari Lena, e cila sheh se “*Zoti i plangut*” qe flijuar për familjen duke punuar ditë e natë, ua merr dorën punëve të bujqësisë, zejeve të ndryshme, madje edhe lakonte hekurin. Nika, dikur grindavec, bëhet njeri i përgjegjshëm dhe i rëndësishëm për familjen.

Novela “*Rrungaja në mars*” trajton jetën e dy heronjve fatkeq, të njohur e të çmuar në mjedisin e vet: ata shquhen si luftëtarë të denjë. Duan një copë më të madhe të lirisë, duan t’i flakin doket patriarkale që ua nxinin jetën. Jera shqetësohet se femra e ndryrë brenda një shtëpie, që ajo e quan shpellë, jeton si s’ka më keq. Zërin e saj nuk e dëgjon askush. Doket e akullta me borë bjeshke mundohet t’i thyejë fillimisht në shtëpi, pastaj merr guximin që këtë ta bëjë edhe në log burrash. I ati me shpirt të venitur i gëzohet vajzës, sepse ia zëvendësonte mallin për një djalë që Zoti nuk ia gëzoi prehrin. Veprimet e Jerës nuk u pëlqenin malësorëve, andaj mu për këtë çështje e këtë ide, novela merr sipërfaqe të universit aksiologjik të personazhit që futet në embrionin e problemeve patriarkale të malësisë.

Jera në kuptimin ideor, psikologjik, sociologjik, antropologjik do ta thyejë botën mesjetare në atë vis. Në këtë mënyrë kërkon liri më të madhe edhe për gjininë femërore, jetë më të mirë për malësoret. Megjithatë barrë të rëndë që mban mbi shpatullat e brishta, në krah të djathtë ka intelektualin e ri: Dakun, bashkënxënës në qytet, thënë figurshëm, Malësisë mundohen t’ia hapin sytë. Të rinjtë e kanë vështirë t’iu largohen dokeve e rregullave absurde, mesjetare.

Novela “*Rrungaja...*” e Martin Camajt, sipas natyrës së diskursit, ka një gërshetim idesh që e lidhin me vepra të tjera që ndryshe quhen metatekste. Në fabulat e tyre ngrihet i njëjti problemi, por niveli i tyre pasqyron këndin e ndjenjave vetjake e të çiltra të filizave të rinj që rriten mes lisave të ashpër e shkëmbinjve me myshqe, me ulërimë ujqish, por që edukohen e arsimohen në qytet.

Idetë e tilla të ndeshura a të gërshetuara në këtë mënyrë, shpeshherë janë një sprovë e madhe kundërshtuese për gjendjen kaotike izoluese të banorëve nga mungesa e rrugëve dhe largësia me qytetin, që është e barabartë me të jetuarit në mesjetë a në gjendje të jashtëzakonshme lufte, situata këto që e kanë rrethuar shpesh malësorin tonë. Dhe jo rastësisht s’ndodh rrokullisja e Dokut me ortekun e borës në shoqëri me ujë. Këto personazhe marrin përmasën e arketipëve kreshnikë. Miqësi me ujë e egërsira kanë pasur vetëm kreshnikët.

Të rinjtë kanë emocione të singerta dhe ndjejnë simpati për njëri-tjetrin, mirëpo veprimi i tyre ka një si shtytje herë të vrullshme e herë tejet inerte nga të dy palët. Djaloshi shpeshherë mundohet ta bëjë “*për vete vashën*”, por në rastet e fundit heq dorë nga aventurat e tilla, ngaqë edhe vetë e kuptoi, se s’duhej të nxitonte, sepse ende ishin të rinj. Në disa çaste ai shtyhet nga gjaknxehtësia. Duket se ka rrebe e damarë të djaloshit brutal. Por ka raste kur është gjakftohtë dhe i përmbajtur, këtë bujari ia imponon bukuria e mençuria e vashës e re. Vasha e kupton krejt ndryshe botën e tij. Liria e tepruar e vashës në Malësi e vë në dilemë djaloshin, i cili trembet se bredhjet e saj vetëm nëpër mal mund të marrin fund duke u rrëmbyer forcërisht nga ndonjë njeri, pa pyetur fare për moshën e saj, ngaqë në Përtejfaqë mungonin femrat. Prandaj ai në mënyrë të posaçme vashën e ruan e kujdeset, por në fund ai nuk e gëzon atë. Në fund, pas zhdukjes së tij nga orteuku i borës ajo do të vuajë shumë.

Novela është shkruar me një realizëm tronditës. Idetë e ngritura në këtë vepër paraqiten me një stil emocionues që pasqyron vetëdijen e banorëve të prapambetur e varfëri. Andaj, jo rastësisht, diskursi i quan njerëz të pashtëpi, turra plangjesh, pa dhoma në hapësirë, që ndezin zjarr flakadanë sa për t’u ngrohur njëzet veta. Synimi i autorit në novelë është përhapja e ideve iluministe për të çliruar nga vargonjtë e jetës mesjetare këta banorë që jetojnë si në një kontinent të harruar dhe me ligje shumë të lashta. Protagonistët janë përfaqësues tipikë që flijohen për të siguruar mbijetesën. Janë arketipë të qëndresës, arketipë të dashurisë platonike, që në fund përfundon tragjikisht për çiftin.

Jeta e tyre ishte tepër e rëndë, gjë që ai parandien se vendi malor do t’ia hajë kokën. Kjo ide, sa fatale e tragjike, është kryefabul. Ajo mbetet të shqyrtohet në ishte jeta proces natyror a sprovë e kohës, jetë e hapësirës së njerëzve me botëkuptime të ndryshme. Ngrehina e tillë letrare nis nga jehona e fuqishme e një diskursi me timbër të veçantë, që shkel në tabanin e traditës së përrallave tona të lidhura me malësinë e ujrit. Novela duket se ka brumin e një legjende që përfundon me fatalitetin e dashurisë platonike. Bota e të rinjve fundoset ende pa filluar. Aty marrin fund emocionet dhe aty hapen plagët e pashërueshme. Veç këtyre, novela merr pamjen e legjendave me ujë, që janë sinonim i miqësisë së kreshnikëve të lashtë. Ujrit në këtë rast simbolizojnë forcën dhe ngrihen kundër pabesisë, lajkave, dredhive. Daku është një arketip i Dragoit dhe i mallkuar nga të tjerët, sepse guxoi e theu traditën, nëpërkëmbi doket; foli haptas për gjëra që ata nuk i kuptonin, u mbante ligjëratat për mënyrën e jetesës, sjelljet njerëzore etj.

Proza poetike “*Dranja*”, parë nga trajta e të shkruarit, është në formën e tregimeve të shkurtëra, që ka ngjashmëri me lirikën. Kjo prozë poetike ndahet në tri pjesë. Në vepër shfaqet madrigali klasik që origjinën e ka te vargjet pastorale klasike italiane. Subjekti i saj është ky: kostarët e gjejnë një breshkë, mbi shpinën e së cilës shëmbëllen se është mbështjellë një gjarpër, por ajo në fakt është rrashta e breshkës. Njëri nga kostarët breshkën e pagëzon Drane, nga emri Drandafille, që shkurtimisht e quajnë Dran: e - ja.

Për këtë vepër letrare mendohet se ka përmbajtje dokumentare. Autori e ka shkruar duke futur në përdorim simbolet dhe mëton ta paraqesë botën e vet, vështirësitë, tragjikën e Dranjes që bledh në fushë, verri, male, brigje, gjatë dimrit hyn nën tokë. Breshka përjeton shtatzëni pas përpjekjes së shtatit me Blerimin, por të njëjtën ndjenjë e përjeton kur në qafë i mërdhezet lëkura, që i duket si therje blete, që ia bën breshkani. Ajo i lakmon njerëzit e dhitë që me dhëmbë të mprehtë përpinin fletët e lisave.

Autori në këtë prozë poetike përdor mjetet artistike si: ironinë, alegorinë, sarkazmin, hiperbolën etj., që i japin formë të pëlqyer “*Dranjës*” së shkruar në formën klasike të madrigalit. Autori me qëllim të caktuar e tejet të tejdukshëm parodizon breshkën Dranjë që s’është thjesht breshkë, por është njeriu ynë. Ideja e tij është përdorimi e fuqia e simboleve, metaforave, metonimisë, të pasqyrojë kaosin në të cilin gjinden banorët e shtypur e të shfrytëzuar deri në palcë. Vetëm në këtë mënyrë mund të lexohet e interpretohet teksti letrar i kësaj proze poetike, që autori e ka shkruar duke pasur kujdes në zgjedhjen e fjalëve. Teksti i “*Dranjës*” ka raste kur i ngjan poetikës së tregimeve të shkurtra të H. L. Borhesit, shkrimtarit realmagjik nga Amerika Latine. Shikuar në pikëpamje të mënyrës së poetikës, autori ironizon sistemin e korruptuar të një shoqërie absurde.

Mbase do të ishte jo e drejtë të heshtnim për të gjitha këto ide të hedhura në letër nga shkrimtari Martin Camaj, që u mundua të konceptojë universin e ideve, sipas parametrave të tij që ishte çështje tejet e ndjeshme. Ai ka një pasqyrë të qartë për kohën e hapësirën që trajton ashtu si ia merr mendja atij që s’dëgjon për imponime e detyrime. Tekstet e servuara të zyrtarëve partiakë fare nuk i përfill. Ai i shkroi veprat e veta mbështetur në logjikën e kulturën e tij, të dalë sipas idesë së tij, që qëllimisht i neglizhon burimet “zyrtare” dhe u jep frymë teksteve të tij që kanë logjikë të fshehur brenda mendjes së thjeshtë të njerëzve të rëndomtë që nuk përfillin politikën e ditës, intrigat e ardhura nga qyteti, etj. Veprat e këtij autori portretizojnë të gjitha format e mundshme të disidencës që janë të lidhura

me problemet njerëzore, historike, etnografike, biologjike, psikologjike, etnografike etj., që i paraqet me nivel artistik të denjë

LITERATURA

- Martin Camaj: “*Djella*”, botoi NB “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 1994, Kosovës.
- Martin Camaj: “*Pishtarët e natës*”, botoi NB “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 1991, Kosovë.
- Martin Camaj: “*Vepra letrare 1 - 5*”, botoi, ShB “Apollonia”, Tiranë, 1996. Shqipëri.
- Martin Camaj: “*Rrathë*”, botim i autorit, Mynih, 1978, Gjermani.
- Martin Camaj: “*Karpa*”, botim i autorit, Mynih, 1987, Gjermani.
- Martin Camaj: “*Parathënie.*”, “Vepra 1, fq.7-47, SHB “Apollonia, Tiranë, 1996, Shqipëri.
- Cvetan Todorov: “*Poetika*”, botoi “Filip Vishnjiq”, Beograd, 1980, Serbi.
- Dr. Zejnullah Rrahmani: “*Teoria e letërsisë*”, botoi “Fakulteti Filologjik”, Prishtinë, 1996, Kosovë.
- Grup autorësh: “*Fjalori i termave letrare*”, botuan: “IKUB” dhe “Nolit”, Beograd, 1986, Serbi.
- Ollga Mihajlovna Frejdenberg: “*Figura dhe nocioni*”, botoi “NZMH”, Zagreb, 1986, Kroaci.
- Sollar Millivoj, “*Ideja dhe rrëfimet*”, botoi “SNL”, Zagreb, 1974, Kroaci.
- Sollar Millivoj, “*Hyrje në shkencën për letërsinë*”, Tiranë, 2004, Shqipëri.
- Sollar Millivoj, “*Teoria e prozës*”, botoi “SNL”, Zagreb, 1989, Kroaci.
- Shafranek Ingrid,- Donat Branimir, “*Themelet e romanit modern*”, botoi “ShK”, Zagreb, 1971, Kroaci.
- Zdenko Shkreb - Ante Stamaq: “*Hyrje në letërsi*”, botoi “Globus”, Zagreb, 1986, Kroaci.
- U. Rene – U. Ostin: “*Teoria e letërsisë*”, botoi “Shtëpia Botues Enciklopedike”, Tiranë, 1993, Shqipëri.

REVISTA

- “*Albanica*”, (numër tematik për M. Camajn) nr. 2, spring (pranverë) 1991, Nju Jork, ShBA.”*Jeta e re*”, (numër tematik për M. Camajn) nr.1, viti XLVII, janar – shkurt, Prishtinë, 1996, Kosovë.
- “*Koha ...*” 2, gazetë e përditshme, dhjetor 1999, Prishtinë, Kosovë.
- “*Shqiptari i lirë*”, më 30. IV- 31. V. 1959, Boston, Mass., ShBA.
- “*World Literature Today*” (Letërsia botërore sot), revistë letrare e Universiteti të Oklahomës, ShBA.

